



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

DOKUMENT POLITIKASH

MENAXHIMI I MBETJEVE NË SHQIPËRI: NJË MUNDËSI PËR TË DEMONSTRUAR ANGAZHIM NDAJ INTEGRIMIT NË BE

Lorena Totoni, Leonie Vrugtman, dhe Diori Angjeli

Menaxhimi i mbetjeve është një nga sfidat më të mëdha mjedisore të Shqipërisë, së bashku me ndotjen e ujit dhe ajrit, degradimin e tokave, dhe humbjen e diversitetit.¹ Në vitin 2011, qeveria hartoi një Strategji Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve mjaft ambicioze që kishte si qëllim harmonizimin e legjislacionit kombëtar të kësaj fushe me rregulloret e BE-së. Gjithsesi, investimet e fundit për ndërtimin e tre incineratorëve kanë ngritur shqetësime serioze mes ekspertëve mjedisorë, aktivistëve të shoqërisë civile, komuniteteve lokale, si dhe Komisionit Evropian², pasi këto lloj impiantesh çlirojnë kimikate të rrezikshme kancerogjene dhe toksike që ndotin ajrin, ujin, dhe tokën. Rrjedhimisht, ndërtimi i këtyre incineratorëve mund të ketë pasoja serioze për shëndetin publik dhe mjedisin në Shqipëri. Përveç kësaj, planifikimi dhe ndërtimi i këtyre impianteve ka qenë jo transparent, ndoshta i manipuluar dhe jo në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ky dokument politikash argumenton se qeveria shqiptare ka një mundësi për të demonstruar angazhimin e saj drejt integritimit në BE duke rishikuar qasjen e saj aktuale ndaj menaxhimit të mbeturinave. Duke i dhënë përparësi riciklimit në vend të incinerimit, Shqipëria mund të tregojë se është serioze në përmbytjen e detyrimeve të anëtarësimit në BE, që rrjedhin nga Kapitulli 27: Mjedisi.

STRATEGJIA KOMBËTARE SHQIPTARE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE

Në vitin 2011, Shqipëria hartoi një Strategji Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve mjaft ambicioze që mbulonte periudhën 2010-2025, periudhë në të cilën qeveria shpresonte se Shqipëria do arrinte të bëhej një shtet anëtar i BE-së. Kjo strategji synonte të harmonizonte legjislacionin e Shqipërisë për menaxhimin e mbetjeve me Direktivën Kuadër të Mbetjeve dhe me *acquis*-në e BE-së. Kuadri legjislativ bazohej në nevojën për të mbrojtur shëndetin publik, mjedisin dhe ekonominë, si dhe synonte që menaxhimi i mbetjeve të shndërrohej në një “çështje prioritare”.³ Ashtu si politika e BE-së mbi menaxhimin e mbetjeve, strategjia e Shqipërisë vuri theksin në zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, ripërtëritjen e burimeve, maksimizimin e riciklimit dhe ripërdorimin e mbetjeve.⁴

Në vitin 2012, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) paralajmëroi se ekspertiza lokale dhe kapaciteti i institucioneve qeveritare nuk do të ishin të mjaftueshme për të arritur standardet e larta të vendosura në strategjinë e Shqipërisë për mbetjet. Për të përmbushur këtë standard, UNECE inkurajoi Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që të forcojë kapacitetin e saj, të

1 PNUD, “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, shih: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/crisis-response.html>.

2 Shqetësimet për menaxhimin e mbetjeve janë shprehur në raportet e progresit dhe në studimet e tjera të autorizuara nga Komisioni Evropian, për shembull: Hogg, Dominic dhe Vergunst, Thomas (2017). “Një vlerësim gjithëpërfshirës i situatës aktuale të menaxhimit të mbetjeve në Evropën Juglindore dhe perspektivat e ardhshme për sektorin duke përfshirë opsionet për bashkëpunimin rajonal në riciklimin e mbetjeve elektrike dhe elektronike”, Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian, shih: http://ec.europa.eu/environment/enlarg/pdf/pilot%20waste/final_report_en.pdf.

3 Qendra e Botimeve Zyrtare (2011), “Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve (2011 – 2025)”, shih: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2011/PDF-2011/36-2011.pdf

4 *Po aty*.

punojë drejt rritjes së ekspertizës së menaxhimit të mbetjeve dhe të bashkëpunojë me ministritë e tjera dhe aktorët vendorë për të zbatuar strategjinë e menaxhimit të mbetjeve.⁵ Shtatë vjet më vonë, raporti i Komisionit të vitit 2018 mbi Shqipërinë vuri në dukje se zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve kishte ngelur në një fazë të hershme⁶, me mospërputhje të mëdha ndërmjet kuadrit ligjor të vendosur dhe realitetit në terren. Komisioni theksoi se Shqipëria duhet të rrisë ndarjen e grumbullimit duke parandaluar prodhimin e mbetjeve, duke promovuar riciklimin dhe duke reduktuar mbetjet e biodegradueshme.

Megjithatë, që nga viti 2013, qeveria braktisi strategjinë e mbetjeve dhe autorizoi ndërtimin e tre incineratorëve, njëri prej të cilëve është aktualisht funksional. Strategjia vërtet përmend incinerimin si një mjet për menaxhimin e mbeturinave, por thekson se kjo metodë ka përfitime të kufizuara dhe është një rrezik serioz për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.⁷ BE-ja gjithashtu konsideron se djegia dhe depozitimi janë opsionet më pak të favorshme për menaxhimin e mbetjeve (shih gjithashtu Figurën 1) dhe “duhet të aplikohet vetëm pasi të jenë ezauruar të gjitha format e tjera të menaxhimit të mbetjeve”.⁸

Ndërtimi i këtyre incineratorëve ka bërë që qeveria shqiptare të rishikojë strategjinë kombëtare të vitit 2011 dhe drafti i ri, i cili mbulon periudhën 2018-2033, është tashmë i disponueshëm në internet.⁹ Dokumenti përcakton sërish objektiva për riciklimin në përputhje me legjislacionin e BE-së, por nuk përmban detaje se si qeveria shqiptare planifikon t’i arrijë ato. Zbatimi i strategjisë së re është një çështje me rëndësi të madhe pasi investimi prej 169 milionë euro për incineratorët është tepër i madh krahasuar me GDP-në e vendit prej 13 miliardë euro¹⁰ dhe me buxhetin vjetor për menaxhimin e mbeturinave urbane, i cili ishte pak më shumë se 2 milionë euro në vitin 2018.¹¹ Ky investim lë hapësirë të vogël për krijimin e një sistemi më të mirë të riciklimit dhe nxitjen e parandalimit të prodhimit të mbetjeve nga konsumatorët, si për shembull, nëpërmjet ripërdorimit të produkteve.

5 UNECE (2012), “Rishikimi i Dytë i Performancës Mjedisore për Shqipërinë”, shih: <http://www.unece.org/index.php?id=31558>.

6 Komisioni Evropian (2018), “Raporti 2018 për Shqipërinë”, shih: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>.

7 Qendra për Botimet Zyrtare (2011), *Op. Cit.*

8 Bashkimi Evropian (2010), “Të jesh i zgjuar me mbetjet: qasja e BE ndaj menaxhimit të mbetjeve”, shih: <http://ec.europa.eu/environment/waste/pdf/WASTE%20BROCHURE.pdf>.

9 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (2018), “Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve (2018 – 2033)”, shih: <https://www.mjedisi.gov.al/strategjia-e-mjedisit/>.

10 Banka Botërore (2017), PBB (në US\$), shih: <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.CD>

11 Ministria e Financës dhe Ekonomisë (2019), Tabela 1 – Buxheti 2018 (Institucionet me programe dhe shpenzimet e tjera), shih: <https://financa.gov.al/buxheti-2018-fillestar/>.

INCINERIMI, QASJA MË PAK E PREFERUAR NDAJ MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Rreziqet ndaj shëndetit publik dhe mjedisit

Fokusi aktual mbi incinerimin si një mënyrë për të menaxhuar mbetjet jo vetëm i kundërvihet legjislacionit të BE por krijon gjithashtu shqetësime mbi ndikimin që ky proces do të ketë mbi mjedisin dhe shëndetit publik në Shqipëri. Incinerimi shihet si një nga alternativat për të zëvendësuar landfill-et, të cilat njihen për potencialin e tyre të lartë për çlirimin e metanit, dhe kontaminimin me kimikate të ujit nëntokësor, atij sipërfaqësor dhe dheut. Mbështetësit e incinerimit deklarojnë se kjo metodë është më pak e dëmshme për mjedisin krahasuar me përdorimin e landfill-eve, pasi mund të ulin çlirimin e gazeve me efekt serë¹². Me të vërtetë, krahasuar me metodën e landfill-it¹³ incinerimi është një mundësi më e mirë. Megjithatë, për momentin në Shqipëri ka alternativa të tjera për menaxhimin e mbetjeve të cilat janë të nën përdorura dhe që përbëjnë më pak rrezik ndaj mjedisit si minimizimi i mbetjeve, riciklimi dhe ripërdorimi i produkteve¹⁴. Për këtë arsye, Direktiva Kuadër e Mbetjeve insiston më tepër tek shmangia e gjenerimit të mbetjeve në vend të incinerimit apo gruposjes së tyre. (Kutia 1).

Nëse zhvillohet brenda kushteve të kontrolluara dhe në objekte moderne, incinerimi mund të përdoret për të prodhuar elektricitet ose lëndë djegëse për procese të caktuara industriale. Gjithsesi, djegia e keqe ose e paplotë e mbetjeve mund të çojë në çlirimin e lëndëve kimike kancerogjene e toksike¹⁵. Veçanërisht i rrezikshëm është fakti që incinerimi lëshon nanogrimca toksike të cilat janë aq të vogla sa të përshkojnë membranën e mushkërive dhe të hyjnë më pas në sistemin e qarkullimit të gjakut¹⁶. Sapo hyjnë në këtë sistem, ato mund të zhvendosen në çdo pjesë të trupit, përfshirë këtu edhe trurin, çka mund të shkaktojë sëmundje neurodegenerative si Alzheimeri, Parkinsoni apo Huntigtoni.¹⁷

12 Kasper, Matt (2013), "Energy from Waste Can Help Curb Greenhouse Gas Emissions", shih: <https://www.americanprogress.org/issues/green/reports/2013/04/17/60712/energy-from-waste-can-help-curb-greenhouse-gas-emissions/>.


13 Metoda e landfill-it nënkupton përcaktimin e një hapësire për shkarkimin dhe gruposjen e mbetjeve.

14 The National Toxics Network (2014), "10 Reasons Why Burning Waste for Energy is a Bad Idea", shih: <https://ntn.org.au/10-reasons-why-burning-waste-for-energy-is-a-bad-idea/>.

15 Bashkimi Evropian (2010), *Op. Cit.* dhe World Health Organisation, shih: https://www.who.int/water_sanitation_health/medicalwaste/en/smincinerators3.pdf.

16 Connett, Paul. (n.d.). "Why incineration is a very bad idea in the Twenty First Century", Global Alliance for Incinerator Alternatives, shih: <http://www.no-burn.org/why-incineration-is-a-very-bad-idea-in-the-twenty-first-century/>

17 Oberdörster, G. Elder, A. and Rinderknecht, A. (2009). "Nanoparticles and the Brain: Cause for Concern?" *Journal of Nanoscience and Nanotechnology*, 9(8), 4996-5007. doi:10.1166/jnn.2009.GR02 dhe EU Joint Programme on Neurodegenerative Disease Research. (n.d.). "What is neurodegenerative disease?", shih: <http://www.neurodegenerationresearch.eu/about/what/>



Kutia 1 Hierarkia e mbetjeve sipas përfytyrimit të Direktivës së BE në Kuadër të Mbetjeve¹⁸

Përkrahësit e incineratorëve përmendin potencialin e metodës për përfitim të energjisë, përfshirë këtu prodhimin e elektricitetit, avullit apo ngrohjes për ndërtesa. Gjithsesi, përfitimi i energjisë përmes incinerimit “nuk është një nga mënyrat më efektive për menaxhimin e materialeve të përdorura, sidomos atyre të cilat janë të vështira për t’u djegur apo që çlirojnë lëndë kimike në temperatura shumë të larta”¹⁹. Sipas Paul Connett, profesor në kimi mjedisore dhe toksikologji, kursehet tre deri në katër herë më tepër energji nëse materialet ricikohen në vend që të digjen²⁰. Për sa i përket ndikimit mbi klimën, incineratorët çlirojnë më tepër CO₂ për njësi energjie se termocentralet e furnizuara me qymyr.²¹ Për më tepër, energjia e prodhuar nga incineratorët nuk është e rinovueshme. Shumë nga materialet të cilat digjen në incineratorë mund të riciklohen ose ripërdoren. Djegia e këtyre burimeve dekurajon zgjidhjet e qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve.

Pavarësisht këtyre rreziqeve, për momentin në Shqipëri nuk ka rregullore të cilat të monitorojnë ndotjen prej nanogrimcave nga ana e incineratorëve pavarësisht pasojave të njohura negative ndaj shëndetit publik. Përgjatë viteve, zhvillimet teknologjike kanë bërë të mundur kapjen e këtyre ndotësve por gjithçka varet nga sa mirë janë të projektuar, të operuar dhe të monitoruar impiantet dhe se me çfarë efikasiteti zbatohen rregullat. Kjo është edhe arsyeja se pse zakonisht incineratorët e rinj bëhen subjekte të investigimeve të detajuara mbi rreziqet që mund të shkaktojnë ndaj shëndetit.

¹⁸ Imazhi nga Centre for Clean Air Policy (2012), marrë nga <https://ccap.org/>

¹⁹ Bashkimi Evropian (2010), *Op. Cit.*

²⁰ Connett, Paul. (n.d.), *Op. Cit.*

²¹ The National Toxics Network (2014), *Op. Cit.*

Mangësi në përgatitjen e projektit

Legjislacioni i BE-së mbi incineratorët vendos parametra për çlirimin e gazrave dhe kërkon që ato të monitorohen vazhdimisht. Shumë njerëz në Shqipëri shqetësohen se incineratori funksional në Elbasan dhe ata të projektuar në Fier dhe Tiranë, nuk janë ndërtuar sipas këtij legjislacioni. Shqipëria nuk ka eksperiencë të mëparshme në ndërtimin e impianteve të menaxhimit të mbetjeve dhe nuk ka procedura rigorozë dhe transparente të Vlerësimit të Impaktit Mjedisor që të shoqërojnë lejet e ndërtimit të këtyre incineratorëve. Për më tepër, nuk janë zhvilluar matje dhe kontrolle për krijimin e një baze fillestare të dhënash të indikatorëve të shëndetit për banuesit në zonat rrethuese. Bazë e cila duhet të shërbejë si pikënisje për vendosjen e një sistemi të rregullt monitorimi dhe vlerësimi mbi impaktin mjedisor të incineratorëve.

Incineratori i Elbasanit është tanimë plotësisht funksional pavarësisht mungesës së sistemeve ex-ante apo ex-post të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe pavarësisht mungesës së garancisë se standardet e BE-së janë respektuar gjatë ndërtimit dhe funksionimit të tij. Veç kësaj, studimi i fizibilitetit të incineratorit të Tiranës nuk jep asnjë alternative tjetër për trajtimin e mbetjeve urbane. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve (2010-2025) përcakton qartë se incenerimi është një opsion vetëm nëse të gjitha mundësitë e tjera janë konsumuar. Si rrjedhim, studimi i fizibilitetit nuk mund të nxjerrë përfundime se krijimi i një incineratori është qasja më e qëndrueshme dhe zgjidhja më e mirë.²²

Sipas një investigimi të zhvilluar nga Website-i i lajmeve HASHTAG, lejet Mjedisore dhe të Ndërtimit për incineratorin e Fierit janë përfutur në mënyrë të paligjshme²³ duke rritur kështu dyshimet edhe mbi ligjshmërinë e lejeve të ndërtimit për incineratorët e tjerë. Toka mbi të cilën po ndërtohet incineratori i Fierit është certifikuar si tokë bujqësore dhe bën pjesë në zonën kryesore të prodhimit të ushqimeve në rang kombëtar me drejtim tregun vendas (Kutia 2). Kontaminimi i ajrit dhe ujërave nëntokësorë që pritet të ndodhë nga aktivizimi i incineratorit të Fierit kualifikohet si krim mjedisor nga Kodi Penal Shqiptar dhe mund të dënohet me deri në 10 vite burg.²⁴ Megjithatë, teksa Shqipëria ka mungesë të një sistemi kombëtar të integruar për menaxhimin e mjedisit dhe monitorimin e të dhënave mbi cilësinë e ajrit dhe çlirimin e gazrave serë, është e paqartë nëse ndotja e shkaktuar nga incineratorët do të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë të rregullt.²⁵

22 Qendra Mjedisore EDEN (2019), "Deklaratë për median mbi incineritorin e Tiranës", shih: <http://www.eden-al.org/index.php/al/>.

23 HASHTAG (2018), "INCENERATORI I FIERIT – Qeveria miratoi ndërtimin mbi truallin e falsifikuar", shih: <https://hashtag.al/index.php/2018/02/21/inceneratori-fierit-qeveria-miratoi-ndertimin-mbi-truallin-e-falsifikuar/>.

24 Kodi Penal Shqiptar, Ligji 9/201 diskuton ndotjen e ajrit dhe ligji 9/203 diskuton ndotjen e ujit, shih: <http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf>.

25 UNECE (2018), Albania Environmental Performance Reviews, shih: https://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/epr/epr_studies/ECE.CEP.183_Eng.pdf.

Incineratori i Fierit është ndërtuar afërsisht 700m larg fshatit Vërri, në zemër të fushës së Myzeqesë. Zona është e njohur për tokën e saj pjellore dhe konsiderohet si hambari i Shqipërisë. Fermerët e rajonit janë të shqetësuar se ndotja nga incineratori do kontaminojë të mbjellat e tyre me kimikate kancerogjene dhe toksike, ndërsa banorët e fshatit janë të shqetësuar se ndotja do të përkeqësojë cilësinë e ajrit duke dëmtuar kështu popullsinë lokale.

Komuniteti e ka shprehur shpesh shqetësimin e tij mbi pasojat e mundshme të procesit incinerues në këtë objekt. Në fillim të vitit 2018, banorët e Vërri-së nisën një petition kundër ndërtimit të incineratorit i cili mbledhi rreth 1300 firma. Pas kësaj, komuniteti vendas, së bashku me AKIP (Aleanca Kundër Importit të Plehrave), paditën në Gjykatën Administrative dy ministritë përgjegjëse dhe kompaninë që po ndërtonte incineratorin me qëllim ndërprerjen e projektit. Çështja u mbyll brenda pak ditëve por AKIP dhe banorët bënë një provë të dytë duke ndaluar procesin e ndërtimit deri në momentin që do gjykata do të merrte një vendim.

Kutia 2 Çështja e impiantit të incinerimit të mbetjeve në Vërri, Fier²⁶²⁷

Mungesa e transparencës

Përveç kritikave të përgjithshme ndaj incinerimit si një mënyrë për të menaxhuar mbetjet, ka gjithashtu mjaft shqetësime mes aktivistëve mjedisorë, shoqërisë civile dhe publikut në përgjithësi mbi mungesën e konsultimeve publike për sa i përket planifikimit dhe zhvillimit të incineratorëve në Shqipëri.²⁸²⁹ Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) midis Shqipërisë dhe BE-së hyri në fuqi në Prill të vitit 2009. Sipas MSA, akordimi i kontratave publike mbi bazat e mos-diskriminimit dhe reciprocitetit është një objektiv kryesor, prandaj është i nevojshëm një vlerësim më i gjerë dhe më i thellë i kuadrit të prokurimit publik dhe konkurrencës/financimeve me fonde publike.³⁰ Në vitet 2014 dhe 2015, qeveria hapi pa prituri procedurat e tenderimit për ndërtimin e tre incineratorëve. Kompanitë patën mundësi të bënin ofertat e tyre për këto tendera ku përfshiheshin të drejtat dhe fondet për zhvillimin e këtyre projekteve dhe ku pritej që fituesit do të ishin ata që do të bënin ofertën më të mirë. Sipas disa dokumenteve të siguruara nga Zëri i Amerikës, të gjithë konkurruesit për këto tendera ishin pjesë e një rrjeti kompanish të vogla të regjistruara “offshore” dhe me – në atë kohë – pronarë të panjohur.³¹ Zëri i Amerikës dhe Exit.al kanë mundur t’i identifikojnë këta pronarë

26 Rama, Artan. (2017), “Waste Management, Government Failure, and Windfalls for Suspicious Businesses”, Exit.al, shih: <https://exit.al/en/2017/10/02/waste-management-government-failure-and-windfalls-for-suspicious-businesses/>.

27 Për më tepër informacion mbi ecurinë e gjykimit shihni faqen në Facebook të Aleancës Kundër Importit të Plehrave (AKIP) në <https://www.facebook.com/AleancaKunderImportitPlehrave> dhe mbulimin mediatik në Hashtag: <https://hashtag.al/index.php/2018/12/12/incineratori-ne-fier-banoret-dhe-akip-ngrene-padi-ne-gjykate/>

28 Shih postimet e AKIP në Facebook: @AleancaKunderImportitPlehrave

29 Qendra Mjedisore EDEN (2019), *Op. Cit.*

30 Qendra e Publikimeve Zyrtare (2006), “Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë”, shih: https://www.parlament.al/Files/Integrimi/marreveshja_e_stabilizim_asociimit_be_shqiperi_23381_1.pdf

31 Bogdani, Aleksandra (2018), “Koncesionet e debatueshme të inceneratorëve në Shqipëri”, Zëri i Amerikës”, shih: <https://www.zeriamerikes.com/a/koncesionet-inceneratore/4406473.html>.

duke zbuluar se shumica e këtyre kompanive zotëroheshin nga i njëjti grup personash, pjesa më e madhe e të cilëve ishin të përfshirë në kompanitë që fituan tenderat.

³²³³. Publikimi i këtyre dokumenteve zbuloi se procesi i zgjedhjes dhe konkurrimit për këto tendera ishte jo-transparent dhe i manipuluar. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë qeveria ka vepruar në kundërshtim me MSA-në.

Për më tepër, do të nënkuptonte që qeveria veproi në favor të personave pranë saj, dhe jo në favor të interesit të qytetarëve Shqiptarë. Ndërkohë, edhe opozita e ka akuzuar qeverinë për dhënien e kontratave koncesionare për klientët e saj. Zef Preçi, Drejtor i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike, dhe Lavdosha Ferruni, aktivist mjedisor, shkojnë aq larg sa të akuzojnë qeverinë për “klientelizëm në dëm të taksapaguesve shqiptarë”.³⁴ Veçanërisht shqetësuese është se, në vende në zhvillim si Shqipëria, investimet e mëdha për incineratorë janë një barrë e madhe për buxhetin e shtetit. Pjesa më e madhe e parave të investuara në këta incineratorë do të përfundojë në xhepat e kompanive që do t’i ndërtojnë ato.³⁵ Përveç investimeve fillestare prej 169 milion euro për ndërtimin e impianteve³⁶, djegia e mbetjeve do të paguhet nga “ndotësit”, në këtë rast qytetarët Shqiptarë. Për 30 vitet e ardhshme, “ndotësi” do të pagujë 29 eurocentë për ton mbetje që do të incinerohen pa pasur mundësinë e negociatave mbi kushtet dhe tarifat.³⁷

Pasi kompanitë fituan të drejtat dhe fondet për projektet, mungesa e konsultimeve publike vazhdoi. Komunitetet lokale mbetën të painformuara mbi vendndodhjen e incineratorëve deri në momentin kur u mor vendimi, gjë që ngjalli shumë protesta dhe kundërshtime.³⁸ Për rrjedhojë, banuesit e fshatrave përreth kanë kërkuar vazhdimisht të jenë më të përfshirë e të informuar. Në Fier, ku ndërtimi i incineratorit ka dy vjet që ka filluar, banorët e fshatrave fqinjë nisën peticione, duke kërkuar konsultime publike, dhe protestuan disa herë kundrejt planeve për incineratorin. Në Janar 2018, një protestë u shtyp në mënyrë të dhunshme nga ndërhyrja e policisë.³⁹ Pavarësisht ekzistencës së legjisllacionit që i kërkon qeverisë lokale dhe asaj qendrore të jetë transparente dhe t’i përgjigjet thirrjeve publike për konsultim, qeveria nuk ka dhënë akoma informacionin bazë që i kërkohet.⁴⁰

³² *Ibid.*

³³ Rama, Artan (2017), *Op. Cit.*

³⁴ Bogdani, Aleksandra (2018), *Op. Cit.*

³⁵ Connett, Paul (n.d.), *Op. Cit.*

³⁶ €22M për impiantin e Elbasanit, €25M për atë të Fierit dhe €122M për impiantin e Tiranës. Shih Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve (2018-2033) për reference të mëtejshme.

³⁷ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (2018), *Op. Cit.*


³⁸ Balkan Web (2018), “U përleshën me policinë, pranga katër protestuesve në Fier (EMRAT)” shih: <https://balkanweb.com/u-perleshen-me-policine-pranga-kater-protestuesve-ne-fier-emrat/> and Koleka, Benet (2016), “Albanians protest law allowing refuse imports for recycling”, available at: <https://www.reuters.com/article/albania-protests-waste/albanians-protest-law-allowing-refuse-imports-for-recycling-idUSL8N1C64N1>.

³⁹ *Exit.al* (2018), “Police Beats Anti-Incinerator Protestors in Verri”, shih: <https://exit.al/en/2018/01/22/policia-beats-anti-incinerator-protestors-in-verri/>.

⁴⁰ Qendra Kombëtare e Regjistrimit (2014), Ligji mbi “Njoftimin dhe Informimin Publik”, shih: http://www.qkr.gov.al/media/1308/lgji-146_2014-ne-anglisht.pdf.

Kapaciteti i Incineratorëve

Pavarësisht argumentave të ndryshëm kundër incineratorëve, problemi qëndron gjithashtu në faktin se kapaciteti i përgjithshëm i incineratorëve në Elbasan, Fier dhe Tiranë e tejkalon sasinë e mbetjeve të prodhuara në Shqipëri të cilat mund të trajtohen nga incineratorët (Kutia 3). Versioni i rishikuar i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve (2018-2033) parashikon se potenciali djegës për mbetjet e gjeneruara në Elbasan, Fier dhe Tiranë është vetëm 26% (ose 123,00 ton) e kapacitetit të parashikuar të incineratorëve.⁴¹ Kjo sasi ka pak mundësi të ndryshojë në vitet e ardhshme teksa qeveria planifikon të riciklojë dhe ripërdorë më tepër mbetje në mënyrë që të përmbushë standardet e BE mbi menaxhimin e mbetjeve. Strategjia paraprake mbi menaxhimin e mbetjeve (2018-2033) ka vendosur objektiva për riciklim deri në 50% në 2020 dhe 65% në 2025, krahasuar me 17% në 2017⁴². OJQ-të lokale përmendin me të drejtë se në mënyrë që të plotësohet kapaciteti i incineratorit të Tiranës, i gjithë qarku i Tiranës do të duhej të ndalonte procesin e riciklimit për 30 vitet e ardhshme⁴³. Strategjia paraprake pranon se qasja aktuale për menaxhimin e mbetjeve i krijon vështirësi Shqipërisë për arritjen e objektivave të detyrueshme të BE për riciklimin. Për të mbyllur hapësirat midis kapacitetit të incineratorëve dhe mbetjeve të gjeneruara në Shqipëri (parashikohet se 74% e kapacitetit të incineratorëve do të mbetet e papërdorur), qeveria propozon që të importohen mbetje nga bashkitë e tjera ose nga jashtë shtetit. Kjo do të krijonte akoma edhe më tepër ndotje të panevojshme në formën e kimikateve kancerogjene e toksike në ujin, ajrin dhe tokën Shqiptare.



Kutia 3 Vizualizim i kapacitetit të incineratorëve dhe mbetjeve vendase të përshtatshme për incinerim

*Përlllogaritjet tona supozojnë se sasia totale e mbetjeve të prodhuara në Shqipëri do të ngelet e njëjtë, pavarësisht popullsisë në rënie dhe rritjes së fokusit mbi shmangien e mbetjeve.

**Përlllogaritjet supozojnë se nga viti 2020 e më pas, kur objektivat e riciklimit do të lëvizin nga 25% në 50%, sasia e mbetjeve vendase të përshtatshme për incinerim do të bjerë në 15%.

***Kapaciteti do të rritet teksa pritet të përfundojnë incineratorët e Fierit dhe Tiranës, në 2022 dhe 2024 respektivisht (parashikim)

41 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (2018), *Op. Cit.*

42 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (2018), Tabela 2, faqe 17, *Op. Cit.*

43 Qendra Mjedisore EDEN (2019), *Op. Cit.*

RRUGA DREJT SË ARDHMES

Dokumenti argumenton se fokusimi i qeverisë tek incinerimi si një mënyrë për të menaxhuar mbetjet – në vend të parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit – shkon kundër standardeve të vendosura ne aquis dhe mund të shndërrohet në një goditje të rëndë për procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Jo vetëm që incinerimi është i dëmshëm për shëndetin publik dhe mjedisin, por këto projekte janë shoqëruar gjithashtu me polemika për favorizime të padrejta. Si përfundim, ky dokument parashtron një sërë rekomandimesh afat-gjata dhe afat-shkurtra, në mënyrë që të ndihmojë përmirësimin e qasjes së Shqipërisë ndaj menaxhimit të mbetjeve dhe ta afrojë atë më tepër me standardet e BE. Këto rekomandime përfshijnë:

- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të specifikojë se si parashikon të arrijë synimet e vendosura për riciklimin që parashtrihen në draftin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve për periudhën 2018-2033.** Buxheti që do të rezultonte nga rishikimi i incineratorit të Tiranës, do të duhej të shkonte për investime në mënyra më të sofistikuar riciklimi. Një sistem më i mirë për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve kontribuon për një shëndet publik më të mirë dhe një ekonomi më të qëndrueshme dhe qarkulluese – gjë që do të demonstrojë angazhimin e qeverisë për respektimin e standardeve të BE.
- **Komisioni Evropian duhet të kryejë një vlerësim të përgjithshëm mbi procedurat e tenderimit të incineratorëve nga ana e qeverisë Shqiptare** si një përgjigje ndaj ankesave mbi shkeljen e mundshme të MSA (Artikujt 71, 74/3 dhe 126) dhe pyetjeve të ngritura nga media mbi partneritetin e mundshëm privat-publik të ndihmuar nga mungesa e transparencës, mosrespektimi i standardeve të konkurrimit të ndershëm dhe shtrembërimi i tregut të lirë. Nëse vërtet do të konstatohet një shkelje e Marrëveshjes, atëherë do të jetë e nevojshme gjetja e një zgjidhjeje të pranueshme për të gjitha palët dhe në respekt të shëndetit publik në Shqipëri.
- **Qeveria Shqiptare duhet të marrë në konsideratë anulimin ose të paktën të rishikojë kapacitetin e impiantit të planifikuar të incinerimit në Bashkinë e Tiranës.** Kapaciteti i inceneratoreve të planifikuar është të paktën 4 herë më i madh se sasija e mbetjeve të trajtueshme që Shqipëria prodhon. Ndërtimi i këtij incineratori, jo vetëm është më i shtrenjti nga të tre impiantet (122 mil Euro), por është edhe ai që ka pasur më pak progres nga të tre projektet.
- Edhe pse çështja e incineratorit të Fierit ndodhet akoma nën gjykim në gjykatën administrative, **ne inkurajojmë zyrën e prokurorisë të hapë një çështje gjyqësore paralele e cila të ketë si subjekt vendimin e paligjshëm të alokimit të tokës bujqësore si shesh ndërtimi për ndërtimin e një incineratori.** Ka prova se leja e ndërtimit dhe Vlerësimi i Impaktit kanë pasur probleme dhe janë në kundërshtim me legjislacionin vendas.
- **Bashkitë dhe institucionet përkatëse publike duhet të garantojnë procese konsultuese me komunitetet lokale,** siç përcaktohet nga ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, duke u ofruar mundësi të plota menaxherëve të projekteve për të marrë informacion nga komunitetet lokale. Konsultimet publike fuqizojnë komunitetet lokale dhe i lejojnë ato të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes, në formën e demokracisë së vërtetë.

Shqipëria e gjen veten në një kontekst Evropian në të cilin zgjidhje më të gjelbërta sesa eliminimi i mbetjeve, si riciklimi dhe kompostimi, janë shndërruar në normë. Themelimi i një “kulture incinerimi” në Shqipëri shkon kundër aspiratës kombëtare që synon integrimin Evropian. Komisioni Evropian ka shprehur gjithashtu pakënaqësitë e tij në

lidhje me zgjedhjen e Shqipërisë për tu mbështetur tek incinerimi.⁴⁴ Përveç problemit të dukshëm mjedisor, sinjale të korrupsionit dhe vlerësimeve të dobëta të impaktit kanë krijuar ndarje ndërmjet autoriteteve dhe komuniteteve lokale të ndikuara nga ndërtimi i këtyre incineratorëve. Si rrjedhojë, duke ri-konsideruar qasjen e saj kundrejt menaxhimit të mbetjeve, qeveria Shqiptare ka mundësinë për të treguar vendosmërinë e saj për plotësimin e angazhimeve formale ndaj Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit që rrjedhin nga nenet 71, 74/3 dhe 126, por gjithashtu – si një vend që aspron anëtarësimin në BE– të tregojë devotshmërinë ndaj parimeve themelore të Bashkimit Evropian.

44 Hogg, Dominic and Vergunst, Thomas (2017), *Op. Cit.*



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Rr. Shenasi Dishnica, Nd.a35, H.1, 1017, Tirana | T +355 4 240 0241 | info@idmalbania.org



[/company/idm-albania](https://www.linkedin.com/company/idm-albania)



<http://www.idmalbania.org/>



[/idm_albania](https://twitter.com/idm_albania)



[/IDMALbania](https://www.facebook.com/IDMALbania)